



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI  
PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2022

**PËR  
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 113, DATË 25.10.2015  
“PËR URDHRIN PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:**

Në ligjin nr.113, datë 25.10.2015, “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 7, pika 2 dhe 4 shfuqizohen.

**Neni 2**

Pas nenit 7, shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 7/1**

**Të drejtat e anëtarit të Urdhrit**

Anëtari i Urdhrit ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin e mjekut veterinar.
2. Të ankohet në organet e Urdhrit, kur i shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom, të lirë dhe të pavaruar të profesionit nga cilido qoftë.
3. Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit, për problemeve që kanë të bëjnë me profesionin e tij.
4. Të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për edukimin e vazhdueshëm veterinar dhe për përparimin e karrierës”.

### **Neni 3**

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

#### **“Neni 9/1**

#### **Detyrimet e anëtarit të Urdhrit**

Anëtari i Urdhrit ka këto detyrime:

1. Të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit në fuqi për veterinarinë, Kodin e Etikës Profesionale dhe Statutin.
2. Të pajiset me certifikatë për ushtrim profesioni dhe të punojë për rritjen e standardeve profesionale, për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe të shëndetit publik veterinar në institucionin ku punon si dhe të marrë pjesë rregullisht në Programet e Edukimit të Vazhdueshëm Veterinar.
3. Të paguajë rregullisht kuotizacionin e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të certifikatës së dhënies të së drejtës së ushtrimit të profesionit si dhe shërbime të tjera administrative, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij”.

### **Neni 4**

Në nenin 14, pikat 1, 2 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

”1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 12 anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga 3 anëtarë të tjerë si më poshtë:

- a) Drejtuesi i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- b) Drejtuesi i Institutit të Shëndetit Publik.
- c) Drejtuesi i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor, Tiranë.

2. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo pesë vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, për një mandat të dytë.

4. President dhe Zëvendëspresident zgjidhet një prej anëtarëve të Këshillit Kombëtar me mandat pesë vjeçar me të drejtën e rizgjedhjes vetëm një herë. Funkzioni i tyre është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese, ekzekutuese apo menaxhuese të administratës shtetërore”.

#### **Neni 5**

Në nenin 23, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Urdhri, financohet nga buxheti i shtetit për vitin 2022, me një mbështetje financiare të caktuar”.

#### **Neni 6**

Zgjedhjet e organeve drejtuese të Urdhrit dhe riorganizimi i tyre në përputhje me këtë ligj, bëhen jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**LINDITA NIKOLLA**